

TOMORR PLANGARICA

PRURJET TEORIKE NË SHKENCAT E LIGJËRIMIT SI MUNDËSI PËR NJË QASJE MË SHUMË NËRILEXIMIN DHE VLERËSIMIN E DRAMATIKËS SË E. HAXHIADEMIT

Është diçka e natyrshme t'i sillesh e risillesh në shqyrtime veprës letrare, duke zgjeruar kështu *historinë e të lexuarit* të saj, histori që nis qysh me kontaktet e para të veprës me lexuesin, dhe zgjerohet e pasurohet në vijimësi përmes brezave të ndryshëm të lexuesve; është ky një proces që dëshmon po ashtu në vijimësi rikuptimësimin e mesazheve të veprës në kontakt me lexuesit e periudhave a epokave të ndryshme; është fat ky të cilin veprat e spikatura e bartin qysh në ngjizje të tyre dhe e ripërtërijnë në vijimësi. Ndërkohë, prurjet shkencore në fushën e studimeve letrare veçse e lehtësojnë këtë proces rileximi e rikuptimësimi, duke mundësuar ndriçimin më të plotë të vlerave të veprës, e njëherazi edhe të institucionit a fushës letrare në kohën kur vepra është shkruar.

Por nuk shfaqet me të njëjtën natyrshmëri rileximi e rikuptimësimi i mesazheve të veprave që në segmente të caktuara kohore të pas botimit të tyre kanë pësuar *dënim me harrim të imponuar* e interpretime dashakeqe.

Me një segment jo të vogël kohor të harrimit të imponuar dhe qasjesh dashakeqe të ndikuara nga faktorë politikë e ideologjikë na shfaqet vepra dramatike e E. Haxhiademit. Rishqyrtimi e rileximi i saj do të duhet të kapërcejë këtë hapësirë boshe të padëshirueshme në *historinë e saj të të lexuarit* dhe të

kompensojë pasojat e saj në kontaktin e tanishëm që vepra rreket të vendosë me lexuesit e një epoke jo të afërt me kohën kur ajo është shkruar (ndërkohë që shijet e të lexuarit, parapëlqimet për gjini e lloje letrare po ashtu kanë ndryshuar dhe dija enciklopedike e lexuesit mbizotërohet nga të tjerë përbërës që zënë vend më me përparësi në të). Dijet, konceptet, metodologjitë në disiplinat e ndryshme shkencore të diskursit letrar e mundësojnë këtë kapërcim; edhe ato të përvijuara në hapësirën e gjuhësisë e shkencave të ligjërimit ndihmojnë në aspekte të ndryshme në këtë proces.

Duke qenë të vetëdijshëm për hapësirën e gjerë që kërkon trajtimi i problematikës së paraqitur në titullin e kumtesës sonë, do të përpiqemi të skicojmë veçse disa nga çështjet që parakupton kjo problematikë, të parashtruara në formë pyetjesh, me përgjigjet përkatëse të përmbledhura.

Përse sjellim sërish në vëmendje e shqyrtim dramatikën e E. Haxhiademit?

Risjellja në vëmendjen e studiuesve e veprës dhe kontributit letrar, publicistik e kulturor të E. Haxhiademit, njërit prej shkrimtarëve që në vitet 1930 kishte merituar një vend të rëndësishëm në institucionin letrar të asaj kohe (por më tej, vepra e tij u dënua me refuzim e harrim të imponuar dhe interpretime dashakeqe të prurjeve të tij në dramatikën shqipe), është tregues i hullisë së duhur në të cilën po lëvizin interesimet dhe angazhimet e studiuesve të letërsisë, tregues i interesimit për ta ndriçuar sa më plotë institucionin letrar a fushën letrare në segmente të caktuara kohore; dhe, në këtë mënyrë, për të ndihmuar që ajo traditë të ndihmojë në zhvillimet e sotme të fushës letrare, të ndihmojë në të ashtuquajturën përballje me *sfidën e modelit* që karakterizon në çdo kohë funksionimin e institucionit letrar. Dhe *modeli* nuk është i përvijuar vetëm nga suksesi i produktit letrar dhe përkatësia në gjini, lloje, rregulla a kode në të cilat ngjizen produktet kulturore e letrare por, më së tepërmi, ai ka të bëjë me përmbushjen e misionit që shkrimtari merr përsipër, suksesin e

pozicionimit të kontribuesve më të shquar në raport me kërkesat e institucionit a fushës letrare të kohës (që bëhet bartëse e shprehëse e kërkesave më të avancuara që shoqëria parashton në një kohë të caktuar të zhvillimit të saj para atij institucioni).

Modele të kësaj natyre janë vijimisht të pranishme në institucionin letrar të çdo kohe, edhe pse ndodh jo rrallë që misionet e tyre mund të mos kuptohen a keqkuptohen kur shkrintari apo artisti krijon, madje të refuzohen, keqkuptohen a moskuptohen edhe më tej, si pasojë e “aksidenteve” kulturore e letrare që shkaktohen nga faktorë ideologjikë e politikë, të cilët, gjithsesi, kanë tjetër jetëgjatësi, janë tejet të përkohshëm në krahasim me jetëgjatësinë e produktit kulturor, letrar e artistik.

Ndaj vjen një kohë që nevoja për t’u përballur me sfidën e modelit, nevoja për të pasur shembuj që mundësojnë pluralitetin e kaheve e angazhimeve në institucionin letrar në një kohë të caktuar, nxisin natyrshëm kërkesën për rishqyrtime, rivlerësime dhe riinterpretime të trashëgimisë, për ta bërë sa më të plotë pamjen e asaj çka përfaqëson ajo trashëgimi, për të njohur a bërë të ditur mënyrat e funksionimit të institucionit letrar e artistik në atë të shkuar, për të parë se si i nxit ai institucion energjitë krijuese dhe u mundëson krijuesve të disiplinojnë energjitë në lidhje me kërkesat që vetë ai institucion përlind, si pasojë e trysnisë sociale të kohës, duke u bërë në këtë mënyrë edhe si ndërmjetësues mes vetë krijuesit dhe shoqërisë.

Gjithsesi, në këto raste shqyrtime mund të përballemi edhe me një mëdyshje të natyrës epistemologjike e etike: i përfshijmë këto vepra sërish në vëmendjen tonë si shenjë respekti dhe vullneti për të mënjeluar një mëkat të së kaluarës, për të bërë një lloj katarsisi a spastrimi moral nga ai mëkat, që nuk ka pse të rëndojë më mbi shpatullat tona, apo si një nevojë që lind nga bindja jonë se vepra përkatëse sjell një segment shtesë në rezultatën e trashëgimisë sonë kulturore dhe, si e tillë, ajo vlen edhe për të sotmen, edhe për më tej. Dhe në rastin tonë, nëse do të shprehemi më drejtpërdrejt: a sjell vlerë, a është i mundur

komunikimi i teksteve të Haxhiademit me lexuesin e sotëm? A shijohet dhe lexohet ai sot? A duhet të integrohet ai në hapësirën që është destinuar për formimin kulturor të brezit të sotëm e për më tej? A është joshëse dramatika e tij për qasjet e sotme dhe drejtimit e ndryshme të studimeve letrare?

Në fakt, rasti Haxhiademi u bë i pranishëm për rishqyrtim e rilexim, madje ndër të parët, qysh në kapërcyellin e viteve 1980-1990. Studiues mendjehapët e të pandikuar nga dogmat politike e ideologjike iu risollën dramatikës së tij duke shfaqur ndaj saj respekt për vlerat letrare e estetike që bartte, me mëtimin që vepra dhe personaliteti i krijuesit të zinin vendin e merituar në trashëgiminë tona letrare.¹ Metodologjitë, konceptet, prurjet teorike në studimin e letërsisë në ditët tona mundësojnë ndriçim edhe më të plotë të kontributeve e vlerave të dramatikës së Haxhiademit; nga ana tjetër, vetë dramatika e Haxhiademit ofron “lëndë të parë” për t’u shndërruar në “objekt studimi” tejet funksional për shkencat tona të ligjërimit, përkatësisht ato të analizës së diskursit letrar, pragmatikës letrare, teorive të të lexuarit, teorive të të thënit/enoncacionit letrar etj. Ndaj risjellja e vëmendjes ndaj dramatikës së Haxhiademit është jo vetëm akt etik, por më së pari një qëndrim estetik, letrar, shkencor për rikuptimësimin e mesazheve të veprës në ditët tona.

A e dëmton receptimin e veprës rileximi i saj në një kohë të mëvonshme, pas një periudhe jo të shkurtër “harrimi” dhe çfarë na sjellin teoritë e të lexuarit në këtë aspekt?

Është tragjike kur shkrimtari i nënshtrohet harrimit të imponuar nga lexuesit e tij, sepse ai ndërpret në këtë mënyrë gjallimin e natyrshëm të veprës së tij, procesin e kuptimësimit

¹ Le të sjellim në vëmendje studimet e A. Plasarit, “Portret i vonuar i tragjikut Etëhem Haxhiademi”, gazeta *Drita*, 9 qershor 1991; “Ideologjia e dashurisë përballë ideologjisë së urrejtjes”, në *Abeli* (pasthënie), Elbasan, Onufri, 1993; të B. Matraxhiut, “Kritikë e tragjedisë dhe tragjedi e kritikës”, revista *Nëntori* 1991/7, etj.

dhe rikuptimësimit të veprës nga lexuesit. R. Escarpit-i, qysh më 1964-ën, theksonte: “Të dish se çka është një libër, do të thotë, më së pari, të dish se si ai ka qenë lexuar”.²

Është i domosdoshëm ky proces i të lexuarit në vijimësi, “sepse vepra nuk është një lloj shugurimi final që provon menjëherë vlerën e saj; ky legjitimim organizon tërësinë e procesit të përvijimit të veprave në funksion të një pararendjeje të mënyrës së saj të funksionimit”³. Ndaj pa këtë proces e megjithë atë shkëputje të konsiderueshme, nga lexuesi i sotëm kërkohet një sforco jo e vogël për të kompensuar këtë boshllëk, këtë harrim. Gjithsesi, teoritë e sotme të të lexuarit, metodologjitë e reja në disiplinat e ndryshme shkencore që angazhohen në studimin e diskursit letrar e kompensojnë këtë ndërprerje me njohuritë e konceptet që ofrojnë në shqyrtim, të cilat lehtësojnë procesin e receptimit të veprës letrare; dhe në momentin e tanishëm ato marrin përparësi edhe në lidhje me veprën e Haxhiademit.

Teoritë e të lexuarit dhe disiplinat e sotme në shkencat e ligjërimit na mundësojnë, mes të tjerash, të reflektojmë në lidhje me dramatikën e Haxhiademit në dy aspekte: 1. T’i japim vendin e duhur lexuesit të sotëm në kontaktin me veprat e tij (por kur themi lexuesi *i sotëm*, kemi parasysh jo çdo lloj lexuesi të sotëm, por atë që zotëron dijen enciklopedike të sotme, që e bën të aftë atë të përballojë procesin e rikuptimësimit e rindërtimit të veprës letrare); 2. T’i japim vendin e duhur në shqyrtime prurjeve, koncepteve dhe metodologjive të përpunuara në shkencat e ligjërimit, që mundësojnë të nxirren në pah jo pak prej veçantive të ngjizjes së veprës, e mes tyre edhe ajo e ngjizjes së saj, duke pasur parasysh edhe lexuesin e saj.

² R. Escarpit, *Sociologie de la littérature*, PUF, Paris, 1964, cituar nga H. Weinrich, në *Conscience linguistique et lectures littéraires*, Maison des sciences de l’Homme, 1989, f. 39-40.

³ Shih më gjerë, D. Maingueneau, *Le contexte de l’œuvre littéraire, Enonciation, écrivain, société*, Dunod, 1993, f. 20.

A është ngjizur dramatika e Haxhiademit duke patur parasysh edhe "lexuesin/spektatorin" e saj dhe si është ngjizur kjo dukuri?

Duke i parakuptuar rolin e merituar lexuesit përmes qasjeve të teorive të të lexuarit të gjysmës së dytë të shekullit XX, le të kujtojmë që interesi për lexuesin, në mënyrë të veçantë në lloje të tilla letrare siç është tragjedia, është i hershëm. Madje, sipas Aristotelit, vetë ky lloj letrar lind duke bartur këtë marrëdhënie e përkujdesje ndaj të destinuarit të mesazheve (lexuesit a spektatorit). Sipas H. Weinrich-ut, "Aristoteli, tragjedinë nuk e përshkruan vetëm prej ndërtimit të saj, por duke u nisur edhe prej efektit të saj, që është të nxisë tmerrin a lebetinë dhe mëshirën te spektatori e lexuesi". Por Aristoteli, vijon Weinrich-u, "shkon edhe më larg. Ai nuk përshkruan vetëm pasionet e tmerrit dhe mëshirës si synime të autorit përkundrejt publikut; ai merr parasysh ndërkohë një lloj paraqitjeje të këtij publiku, të cilin autori duhet ta përlllogarisë. Sipas *Poetikës* së tij [...], këto pasione arrijnë të fitojnë një pushtet të veçantë, kur ato përftohen kundër çdo pritjeje. Përveç kësaj, pritja e publikut shfaq disa linja të qëndrueshme. Për Aristotelin, këto janë, për shembull, vlera të tilla, si lidhjet e prindërisë, ose miqësia: nëse autori vë të përballen armiku me armikun, s'mund të shpresojmë asnjë reaksion mëshire të veçantë. Por, nëse në të kundërt, është miku që përballet me mikun, vëllai që lufton me vëllain, mund të jemi të sigurt që ngjallja e mëshirës do të jetë më e fortë te spektatorët e tragjedisë. [..., ...]".⁴ Haxhiademi e integroi mjeshtërisht këtë estetikë të efektit në tragjeditë e tij, e cila, për më tepër, mbetej funksionale në komunikimin letrar me lexuesin/spektatorin shqiptar të kohës kur ai shkruante. Lexuesi i sotëm e përfshin në një kontekst edhe më të gjerë e funksional këtë "estetikë të efektit" si pasojë e të dhënave edhe më të shumta që zotëron në dijen e tij enciklopedike, duke iu qasur me një kompetencë edhe më të plotë vetë thurimës tekstore të çdonjërit tragjedi, duke zgjeruar e rindërtuar domethëniet e mesazheve në to.

⁴ H. Weinrich, *Conscience linguistique et lectures littéraires*, Maison des sciences de l'Homme, 1989, f. 42-43.

Përse dramatika e Haxhiademit ofron lëndë të parë për t'u shndërruar në objekt studimi edhe nga gjuhësia a shkencat e ligjërimit dhe pse shqyrtimet përmes qasjeve nga këto dije janë të vlefshme për lexuesin e sotëm?

Mbetet hera-herës thjesht një slogan teorik pohimi se zhvillimet e sotme në gjuhësinë a shkencat e ligjërimit mund të ndihmojnë në shqyrtimin e tekstit letrar (posaçërisht edhe të tekstit dramatik), nëse nuk do të qartësojmë se kjo ndihmë është tejet e kushtëzuar nga veçantitë që vërehen në të dyja skajet e këtij raporti. Nga njëra anë, në vetë prurjet e gjuhësisë a të shkencave të ligjërimit, të cilat natyrshëm nuk janë të përdorshme *en bloc* në këtë funksion, por vijnë nga kohë të ndryshme, disiplina, teori e koncepte të caktuara të përpunuara në atë hapësirë; dhe nga ana tjetër, kushtëzohen nga veçantitë e llojit a gjinisë së tekstit letrar, madje nga veçantitë në kohë dhe hapësirë të përvijimit të tekstit letrar përkatës.

Nëpërmjet këtij pikëvështrimi, veprat e Haxhiademit janë ndër tekstet më të përshtatshme për të kuptuar se si mund të bëhen funksionale në shqyrtim prurjet e sotme shkencore në shqyrtimin e diskursit dramatik dhe se si mund të ndikohet përmes këtyre qasjeve në zgjerimin e dijes enciklopedike të lexuesit, duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e kompetencës leximore të tij (ndërsa bie/mund të bjerë në kontakt me lloje letrare të tilla, si tragjedia, të palëvruara në përvojat letrare të sotme).

Gjuhësia e shkencat e ligjërimit gjejnë në dramatikën e Haxhiademit një lëndë tejet të përshtatshme për ta shndërruar në objekt studimi, sidomos në aspekte të tilla që lidhen me teknikat dhe procedetë e ngjizjes së të thënit/enoncacionit në to, veçantitë e ligjërimit të personazheve, madje vetë veçantinë e të folurit të tyre sipas një varianti nëndialektor, që përballon regjistra të ndryshëm gjuhësorë në komunikim. Këto veti e karakteristika të diskursit të tij nxisin më tej të kërkosh dije e koncepte

funkionale në shqyrtim për të motivuar përzgjedhjet e Haxhiademit në lidhje me tregues të ndryshëm, si: parapëlqimet e tij ndaj temave të caktuara që mbushen me një brendi të lidhur ngushtë me përzgjedhjen e gjinisë a llojit letrar jo si mbulesë a kornizë, por me vetë kontekstin e veprës letrare⁵; pra në lidhje me enoncacionin e dyfishtë në ligjërimin dramatik, etosin, patosin dhe kategoritë e tjera retorike në vepër, rolin e maksimave, sentencave a thënieve diturore dhe efektin e tyre në tiradë, si pikëvështime të thënësit zanafillor a archienoncatorit, rolin e paratopisë në procesin e tij krijues dhe përvijimin e paratopive familjare, hapësinore, kohore, gjuhësore, të identitetit në tragjeditë e tij etj. Është një problematikë që e bart vepra e tij dramatike dhe mund të qartësohet veçse me prurjet e sotme të gjuhësisë së ligjërimit a kaheve të ndryshme studimore në shkencat e ligjërimit.

Cilat janë disa nga profilet e tekstit dramatik që ndriçohen më nga pranë prej gjuhësisë e shkencave të ligjërimit, të cilat spikatin edhe në tragjeditë e Haxhiademit?

Analiza e diskursit, pragmatika letrare, analiza tekstore e diskursit dramatik etj. kanë qartësuar tashmë profile të rëndësishme të këtij entiteti letrar përmes të cilave mund të rishqyrtojmë e rikuptimësojmë vepra jo vetëm të së sotmes, por edhe të traditës; e në këtë mënyrë t'i qasemi edhe veprës së Haxhiademit me teoritë e konceptet më të efektshme në shqyrtim. Mund të përmendim kalimthi disa prej këndvështimeve në këto prurje shkencore, të cilat mund të na ndihmojnë edhe në shqyrtimin e dramatikës së Haxhiademit. Ja disa syresh:

⁵ Sipas D. Maingueneau-së, konteksti i veprës letrare “nuk është i vendosur jashtë veprës, në një seri mbështjelljes a mbulesash të njëpasnjëshme, por drejtohet a matarohet nga vetë teksti ; pra vetë teksti është drejtuesi i kontekstit të tij” (D. Maingueneau, vep. e cit., f. 23-24).

- Përkatësia e krijimtarisë së Haxhiademit në një lloj të veçantë të dramatikës, në atë të *tragjedisë*, madje e shkruar duke ndjekur modelet më të shquara të shkrimtarëve të klasicizmit frëng dhe përvojave më të gjera të neoklasicizmit, e ndihmon lexuesin e sotëm të orientohet më lehtë në problematikën jo të thjeshtë të raporteve që vendosin në ditët tona veprat teatrale si arte të spektaklit dhe marrëdhënieve e raporteve të tyre me krijimin letrar apo përkatësinë në diskursin letrar. Përkatësia e krijimtarisë së tij si lloj dramatik në procedetë e pranishme klasiciste dhe neoklasiciste e orienton lexuesin e sotëm drejt natyrës *teksto-centriste* të këtyre përvojave letrare, karakterizuese të tragjedisë klasike. Në pohimet e studiuesve të kësaj fushe theksohet se “tekstualiteti i veprës dramatike i nënshtrohet një mekanizmi të dyfishtë fiksional, që është i ndryshëm sipas epokave: në funksion të përdorimit lektoral dhe atij skenik”.⁶ Në trajtesat e tyre bëhet dallimi mes qëndrimit *teksto-centrist* të estetikës klasike, sipas të cilit, qysh nga Aristoteli deri te Hegeli praktikat e skenës trajtohen si “arte shoqëruese” dhe *skeno-centrizmit* triumfues të sotëm, ku marrin përparësi fuqia e simbolikës skenike, efektet skenike përmes teknologjisë etj.”⁷

Haxhiademi e ngjiz këtë tekstualitet përmes qëndrimit teksto-centrist të përvojës klasike a neo-klasiciste. Edhe pse lexuesi i sotëm ka një kuptim disi më të ndryshëm në lidhje me dramatikën, teatrin, në krahasim me atë të lexuesit të njëqind vjetëve më parë, kur Haxhiademi shkroi tragjeditë e tij, apo të 2-3 shekujve më parë, kur autorët klasikë a neoklasicistë francezë, gjermanë a anglezë shkruan tragjeditë e tyre (pra edhe pse lexuesi i sotëm e vështron dramatikën apo teatrin me një natyrë të dyfishtë, si spektakël e si tekst, madje ku mbizotërojnë elementet e spektaklit - çka nuk e mundëson modeli i tragjedisë të

⁶ Shih J.-P. Dufiet et A. Petitjean, *Approches linguistiques des textes dramatiques*, Classiques Garnier, 2013, f. 7-8.

⁷ J.-P. Dufiet et A. Petitjean, *po aty*.

Haxhiademit), përvojat e mësimdhënies në vendet e tjera tregojnë se veprat e kësaj natyre përvetësohen nga lexuesi përmes të *lexuarit*. Kështu, për shembull, “klasikët francezë *par excellence* (Molieri, Corneille-i, Racine-i, më vonë edhe Hygoi) janë autorë të teatrit, por ata kanë qenë mësuar e bërë të njohur në institucionin shkollor përmes të *lexuarit*. Të *lexuarit* e teatrit përbën kështu një model madhor për procesin e receiptimit letrar”.⁸ Tragjeditë e Haxhiademit mund të qëndrojnë në raport me lexuesin e sotëm në të njëjtat raporte që klasikët francezë (a të tjerë) qëndrojnë me lexuesin e sotëm në vendet e tjera.

- Në veprën dramatike (si edhe në atë romaneske) kemi një lloj shtirjeje në formë loje që lexuesi/spektatori e pranon paraprakisht; ai ndjehet i ftuar të fusë në lojë imagjinatën, domethënë të pranojë ekzistencën e një bote fiktive, ku personazhet përmbushin “seriozisht” dhe interpretojnë jo më pak “seriozisht” akte të shumta të ligjërimit të përcaktuara në vijimësi; ose siç thotë Aragoni, “bëhet fjalë për një gënjeshtër të vërtetë”.⁹ Në veprat e Haxhiademit, lexuesi/spektatori ndjehet lehtësisht i përfshirë në këtë truk a lojë të fikSIONIT, sepse ligjërimi është lehtësisht i deshifrueshëm dhe mendimi i bartur në dialogë a tirada fare pranë botës së tij mendore, vlerave dhe antivlerave që janë pjesë e mentalitetit të tij qytetar. Në procesin e të rilexuarit të dramatikës së tij, nuk duhet harruar kjo veti e diskursit dramatik.

- Njohuritë e konceptet nga shkencat e ligjërimit mundësojnë të bëhet një lloj radiografie gjuhësore e asaj çka mund të quhet “identiteti diskursiv” i gjinisë tekstore dramatike, duke u përqendruar sidomos në disa tregues: në enonciacionin a të thënët dramatik; mënyrat e ngjizjes së këmbimeve gjuhësore; polifoninë enonciative (për më tepër, në rastin e tiradave të shumta ku personazhi vendos një lidhje të drejtpërdrejtë me

⁸ Shih më gjerë A. Viala, *Théâtre*, në “Dictionnaire du littéraire”, sous la direction de P. Aron, D. Saint-Jacques, A. Viala, PUF, 2002, f. 610.

⁹ J.-P. Dufiet et A. Petitjean, *vep. e cit.*, f. 9.

spektatorin dhe ka të brendashkruar zërin e thënësit zanafillor); strategjitë kompozicionale që kanë të bëjnë me kuadrin spacio-temporal, personazhet dhe zhvillimin e intrigës” etj.¹⁰ Theksohet tashmë se shkrimësia dramatike ka të pranishme (paradoksalisht) njëherazi fjalët/të folurin e veçantë të personazheve, por ajo mundëson po ashtu edhe praninë idiosinkratike a të temperamentit të thënësit zanafillor, archienonciatorit, që është dramaturgu. Bëhet fjalë, siç shkruan M. Fumaroli “për një zë të manifestuar në shumë zëra”¹¹; ose, siç thekson Maingueneau-ja, pikëvështrimi i thënësit zanafillor nuk do të jetë as ai i këtij apo atij personazhi, por vënia e tyre në lidhje, për më tepër, vijon ai, “spektatori i kap thëniet e nyjëtuaara nga aktorët në palimpseste, sepse pas fjalëve të nyjëtuaara ka, në shtresën tjetër, ato të shkruara më parë”.¹²

Mundësi të konsiderueshme shprehëse gjen thënësi zanafillor për ta bërë të pranishëm zërin e tij nëpërmjet personazheve që përfaqësojnë heroizmin aristokratik, sepse “ai heroizëm është në parim teatral, madje tejet i dukshëm [...]”.¹³ E gjejmë këtë qëndrim tejet të përshtatshëm për shpjegimin e veçantive që bart edhe dramatika e Haxhiademit, e ngritur mbi personazhe të kësaj përkatësie, me ligjërimin e ngjizur po ashtu me tonin e regjistrat e ngritur ligjërimit që mundësojnë që të brendashkruhet edhe mendimi i dramaturgut, qëndrimet e tij etike a filozofike. Maksimat e famshme po ashtu tejet të pranishme në këtë lloj ligjërimit (në tragjeditë e Haxhiademit prania e tyre formëson një karakteristikë dalluese të menjëhershme) janë shembull ilustrues i pranisë së këtij zëri të brendashkruar; ato mundësojnë që kuptimi të bartet natyrshëm përtej mesazhmarrësit të atypëratyshëm.

¹⁰ Shih më gjerë, J.-P. Dufiet et A. Petitjean, *vep. e cit.*, f. 12.

¹¹ J.-P. Dufiet et A. Petitjean, *vep. e cit.*, f. 26.

¹² Shih më gjerë, D. Maingueneau, *Manuel de linguistique pour les textes littéraires*, Armand Colin, Paris, 2010, f. 336-338.

¹³ D. Maingueneau, *po aty*, f. 345.

Por duket se Haxhiademi ka kapur (qoftë edhe intuitivisht) edhe një ligjësi që pragmaticienët e sotëm e theksojnë më së tepërmi: vetinë e të folurit të përditshëm që është i pajisur me teatralitet. Këtë mjet, këtë veti, Haxhiademi e ka bërë pjesë të ligjërimit të personazheve, pjesë të ndërtimit të këmbimeve gjuhësore në tragjedi. Në këtë pikëvështrim, analiza e ligjërimit në tragjeditë e Haxhiademit mund të shërbejë edhe si një mundësi për të krijuar ide se në ç'mënyrë të thënët e zakonshëm mund të zgjerojë funksionet e tij.

- Dramatika e Haxhiademit u mundëson lexuesve të sotëm, veçanërisht atyre që janë në përvijim e sipër të dijes enciklopedike e kompetencës së tyre leximore, njohjen dhe familjarizimin me një estetikë të veçantë në të cilën janë ngjizur vepra madhore qysh nga antikiteti e deri në kohët e reja, në llojin letrar të tragjedisë, që sipas studiuesve përftohet nëpërmjet tri qasjeve: asaj *antropologjike* (“paraqitja e veprimeve, sjelljeve dhe emocioneve të skajshme që e tejkalojnë masën në sjelljen njerëzore, çka mund të çojë në përjetime të tilla që mundësojnë të çlirohesh prej tyre, t’i largosh ato për të mos qenë në vijim viktimë [...]”); asaj *politike* (“mbreti ose heroi, protagonistët, nëpërmjet vendimeve apo edhe fatkeqësive të tyre, çënojnë a vënë në rrezik edhe fatin e komunitetit që ata drejtojnë”); më së fundi, asaj *ontologjike* (“tragjedia shpreh ankthin dhe revoltën e njeriut ndaj qenies së tij si qenie vdekatare, dhe bëhet pjesë në këtë mënyrë e perceptimit të tragjikes”).¹⁴ Mishërim të këtyre qasjeve lexuesi-nxënës a student, por edhe çdo dashamir i diskursit dramatik mund t’i marrë para se të njihet me kryeveprat në këtë lloj letrar qysh nga antikiteti e më tej, ose ndërkohë a krahas njohjes me këto kryevepra, duke i shtuar dijes së tij enciklopedike edhe një përmasë që i vjen së bashku me ndjesinë e

¹⁴ Cituar nga M.-A. Bernier, L. Desjardins, *Tragédie*, në “Le Dictionnaire du littéraire”, sous la direction de Paul Aron, Denis Saint-Jacques, Alain Viala, PUF, 2002, f. 624.

respektit për trashëgiminë kulturore të vendit të tij e në gjuhën e tij amtare.

Në mbyllje

Nxjerrja në pah e vlerave dhe veçantive të dramatikës së Haxhiademit edhe përmes dijeve, koncepteve e metodologjive që vijnë prej kaheve të ndryshme studimore në shkencat e ligjërimit, mund të na çlirojë nga mëdyshja e natyrshme që lind përballë një korpusi letrar të krijuar pothuaj para njëqind vjetëve, për të cilin në një segment jo të vogël kohor të historisë së tij të të lexuarit shfaqet dënimi me harrim të imponuar. Përballë vlerave e veçantive që dalin në pah mund të orientohet siç duhet e në mënyrë të suksesshme procesi i të lexuarit në ditët tona dhe ky korpus letrar të vijojë procesin e rikuptimësimit të domethënies që teksti bart, duke përmbushur misionet e diskursit letrar për ngjalljen e përjetimeve estetike, por edhe të nxitjes së ndjesive të tjera që kanë të bëjnë me respektin ndaj traditës e trashëgimisë kulturore e letrare, respektit ndaj *modeleve* të intelektualitetit që formësuan personalitetet letrare e kulturore në atë trashëgimi, mes të cilëve edhe Haxhiademi mbetet gjithnjë i domethënës.

